

VENDIM
Nr. 63, datë 29.1.2020

**PËR SHPALLJEN E ZONËS SË RE PËR ZHVILLIM NË NJËSINË
ADMINISTRATIVE FUSHË-KRUJË, BASHKIA KRUJË, DHE ÇAKTIMIN E
FONDIT SHQIPTAR TË ZHVILLIMIT SI NJËSI ZBATUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjeve “iii” e “iv”, të shkronjës “b”, të nenit 13, dhe të pikës 3, të nenit 16, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas hartës dhe koordinatave bashkëlidhur këtij vendimi, të zonës 1, Njësia Administrative Fushë-Krujë, Bashkia Krujë, zonë e re për zhvillim.

2. Çaktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për këtë zonë si njësi zbatuese, për:

- a) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;
- b) ndërtimin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës publike e kritike;
- c) realizimin e ndërtimeve në këtë zonë;
- ç) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të kësaj zone.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Bashkia Krujë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

OBJECTID *	Koord_X	Koord_Y
1	393801.4	4593145
2	393618.8	4593246
3	393635.8	4593275
4	393533.3	4593332
5	393652.4	4593541
6	393677.8	4593574
7	393693.2	4593578
8	393961.6	4593423
9	393801.4	4593145

